



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	06.03.2026
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës - Muaji Shkurt 01.02.2026-28.01.2026

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

DKA edhe gjatë muajit Shkurt ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme:

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Për nderë të ditës së pavarësisë të gjitha shkollat kanë mbajtur aktivitete të ndryshme në të gjitha shkollat.

Nxënësit e SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan dhe Shfmu “Emin Duraku” në Banullë kanë marrë pjesë në panairin **ASEF 2026**-Panairi i Shkenëcs dhe Teknologjisë i mbajtur në Tiranë.

Nxënësit e Shfmu “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan fituan çmime në këto fusha:

- Matematikë 2 vende të para
- Fizikë- vend i parë
- Kimi- vend i tretë
- Biologji- vend i tretë
- Tik 1 vend i dytë dhe 4 vende të treta

Nxënësit e Shfmu “Emin Duraku” në Banullë fituan çmime në këto fusha:

- Fizikë - vendi i parë
- Biologji – vendi i tretë

Kërkesë Departamentit të Prokurimit për zhvillimin e procedurës për:

1. Qiramarrjen e busit për shërbimet e transportit të nxënësve në shkollën "Zenel Hajdini" në Gadime,
2. Furnizimi i IEA me pelet druri për periudhën 12 mujore,
3. Furnizimi me artikuj të ndryshëm për dita të shkollës - kontratë dy vjeqare,
4. Sigurimi fizik i objekteve në shkollat: SHFMU "Vëllezërit Frashëri" - Lipjan, Gjinnazi "Ulpiana"-Lipjan dhe "Adem Gllavica"-Lipjan, Kontratë 3 vjeqare,
5. Transporti i nxënësve parafillor në relacionet Kojskë deri në SHFMU "Drita" Rubofc dhe anasjelltas,
6. Pjerrinës në hyrje të shkollës "Rexhep Akllapi" në Akllap,
7. Trasporti dhe akomodimi i nxënësve në garat ndërkombëtare (përfshirë bujtja, ushqimi dhe transporti i tyre),
8. Instalimi i internetit në disa shkolla dhe shërbimet e rregullta mujore me internet për disa shkolla-kontratë kornizë për periudhën tre vjeqare,
9. Transporti i nxënësve në relacionet brenda fshatërave Gadime e Ulët, Gadime e Eperme dhe Gllavicë deri te SHFMU "Zenel Hajdini" dhe ansajelltas.

Është bërë zotimi në kategorinë Mallra & Shërbime dhe atë:

- Furnizimi me lëndë djegëse DRU në "Adem Gllavica" Lipjan dhe "Braca Aksiq" Lipjan,
- Furnizimi me material të mirëmbajtjes në disa shkolla,
- Furnizimi me material zyrtar dhe letër në disa shkolla,
- Fotokopjet për muajin dhjetor & janar për internet në të gjitha shkollat,
- Marrja e pajisjeve me qera - fotokopjet në shkolla,
- Trasnsporti i nxënësve në shkolla,
- Furnizimi me derivate në disa shkolla dhe derivate – naftë për ngrohje qendrore në çerdhe
- Furnizimi me ushqim dhe pije për Çerdhe,
- Mirëmbajtja dhe servisimi i nxemjes qendrore në disa shkolla (Dobrajë, Medvec, Babush, VII.Frashëri, Rufc, Krojmir),
- Renovimi i kulmit në disa shkolla (Bujan, Kraishtë dhe Çerdhe).

Zotimet në kategorinë komunalit dhe atë:

- Rrymë dhe Mbeturina në shkolla

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe ate:

- Formular për ndryshime–kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim–skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.

STATISTIKAT

Gjatë muajit Shkurt nuk kemi pasur ndonjë statistikë për të paraqitur në raport mujor.

DISKUTIME PUBLIKE (Takime me qytetarë)

- Takim me përfaqësuesit e organizatës joqeveritare VORAE,
- Takime të ndryshme me qytetarë, përkitazi me çështjet që ndërlidhen me Arsimin dhe
- Takime të vazhdueshme me drejtorët e shkollave.

SFIDAT

- Zvogëlimi i numrit të nxënësve në disa shkolla,
- Risistemimi i punëtorëve arsimor të cilët humbin normat për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe
- Rritja e numrit të rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, si pasojë e kësaj komisioni për vlerësimin e këtyre fëmijëve e ka të pamundur t'i vlerësoj të gjithë në kohë reale.

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe
- Angazhimi i psikologeve në trajtimin e temave me rëndësi për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës.

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë.